

L I G J
Nr.7769, datë 16.11.1993

PËR DISA NDRYSHIME E SHITESA NË KODIN PENAL TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozim të një grupi deputetësh,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Neni 1

Paragrafi i parë i nenit 17 ndryshohet si vijon:

Kundër personave që kanë kryer krime jepen këto dënime kryesore :

1. Heqja e lirisë;
2. Burgimi i përjetshëm;
3. Me vdekje.

Në paragrafin e dytë të nenit 17 shfuqizohet pika 3 (riedukimi nëpërmjet punës).

Në paragrafin e tretë të nenit 17 shfuqizohet pika 3 (heqja e të drejtës së zgjedhjeve).

Neni 2

Neni 19 ndryshohet si vijon:

Gjoha është denim në të holla.

Dënimi me gjobë jepet nga dhjetëmijë deri në një milion lekë.

Dënimi me gjobë jepet për veprat penale që e parashikojnë këtë dënim, brenda kufijve të caktuar në paragrafin e dytë të këtij neni.

Kur gjoba nuk paguhet në afatin e caktuar, gjykata vendos zëvendësimin e saj me heqje të lirisë, duke llogaritur 300 lekë për një ditë heqje të lirisë. Masa e dënimit të caktuar nga zëvendësimi nuk mund të kalojë dënimin me heqje të lirisë të parashikuar nga dispozita përkatëse. Në qoftë se i dënuari, gjatë zbatimit të dënimit paguan gjobën, gjykata tërheq vendimin dhe bën llogaritjet sipas kriterëve të caktuara në këtë nen.

Neni 3

Pas nenit 21 shtohet neni 21-a me këtë përmbajtje:

Burgimi i përjetshëm

Dënimi me burgim të përjetshëm jepet me vendim të gjykatës për një krim të rëndë të kryer dhe vuhet në vendet e caktuara për zbatimin e dënimit me heqje të lirisë.

Dënimi me burgim të përjetshëm mund të jepet për krimet e parashikuara nga nenet : 47, 48, 49, 50, 51, 52, 54, 57, 58, 60-a, 62, 65, 84, 94-a, Paragrafi i dytë, 97, paragrafi i dytë, 98, paragrafi i dytë, 101, paragrafi i dytë, 102, 152, 153, 154 dhe 159.

Dënimi me burgim të përjetshëm nuk jepet kundër personave që në kohën e kryerjes së krimit nuk kanë mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, si dhe kundër grave.

Neni 4

Neni 32 ndryshohet si vijon :

Gjykata, në raste të jashtëzakonshme, kur çmon se vepra ka rrezikshmëri shoqërore të vogël dhe vërtetohen jo më pak se dy rrethana lehtësuese të parashikuara nga ky kod mund të caktojë një dënim nën minimumin ose njëlloj dënimi më të butë nga ai që 3 parashikohet nga dispozitat përkatëse të këtij kodi.

Neni 5

Neni 38 ndryshohet si vijon :

Për shkak të rrezikshmërisë së pakët të personit, të pa dënuar më parë, gjykata, kur jep dënim me heqje të lirisë deri në pesë vjet, mund të urdhërojë që i dënuari të vihet në provë, duke pezulluar ekzekutimin e dënimit, me kusht që gjatë kohës së provës i dënuari të mos kryejë vepër tjetër penale po aq të rëndë apo më të rëndë. Afati i provës nuk mund të jetë më pak se një vit dhe as më shumë se pesë vjet.

Kur i dënuari me kusht, brenda afatit të provës, kryen një vepër penale tjetër po aq të rëndë apo më të rëndë se ajo e mëparshme, gjykata tërheq dënimin e dhënë me kusht dhe zbaton rregullat e bashkimit të dënimeve.

Kur gjykata ka dhënë një dënim plotësues, ky zbatohet pavarësisht nëse dënimi kryesor është dhënë me kusht, përveçse kur gjykata vendos ndryshe.

Neni 6

Neni 42-c ndryshohet si vijon:

Kur i dënuari me heqje të lirisë tregon me sjelljen dhe punën e tij se është përmirësuar, me kërkesën e tij gjykata mund të vendosë lirimin para kohe me kusht, pasi të ketë vuajtur dy të tretat e dënimit.

Nuk llogaritet në kohën e vuajtjes së dënimit pjesa e dënimit të falur ose të amnistuar.

I dënuari me burgim të përjetshëm mund të lirohet para kohe me kusht, në raste të jashtëzakonshme, kur ka vuajtur jo më pak se njëzetepesë vjet heqje të lirisë.

Lirimi para kohe me kusht nuk lejohet për të dënuarit persëritës.

Kur i liruari para kohe me kusht dënohet për një vepër tjetër penale po aq të rëndë ose më të rëndë se e para, gjykata tërheq lirimin para kohe me kusht.

Neni 7

Në nenin 56 pas fjalës "raciale" shtohet fjala "fetare".

Në nenin 56 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

Personi që vë në rrezik paqen publike duke bërë thirrje për urrejtje kundër pjesëve të popullsisë, duke i fyer ose shpifur për to, duke kërkuar përdorimin e dhunës ose të veprimeve arbitrare kundër tyre, dënohet:

me heqje të lirisë nga një gjer në pesë vjet.

Neni 8

Neni 57 ndryshohet si vijon:

Krijimi i një organizate me karakter fashist, komunist enverist, totalitarist, terrorist, të drejtura kundër rendit kushtetues, ose pjesëmarrja në to, dënohet:

me heqje të lirisë nga një gjer në pesë vjet.

Neni 9

Pas nenit 57 shtohet neni 57-a, me këtë përmbajtje:

Shpërndarja e materialeve propagandistike antikushtetuese

Përgatitja, shpërndarja ose futja në territorin e Republikës së Shqipërisë e materialeve dhe mjeteve të propagandës të një partie, organizate apo shoqate të ndaluar si antikushtetuese,

antikombëtare, fashiste, raciste, totalitariste, komuniste enversite ose të atyre që janë vazhduese të veprimtarisë së tyre ose të një qeverie, partie, organizate apo shoqate jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të cilat bashkohen në qëllimet me të parat dhe i ndihmojnë ato dënohet:

me heqje të lirisë gjer në tre vjet.

Kjo dispozitë nuk zbatohet kur materialet dhe mjetet e propagandës i shërbejnë veprimtarisë sqaruese për mbrojtjen nga synimet antikushtetuese të artit ose shkencës, kërkimit apo mësimi, informimit mbi ngjarjet e kohës apo të historisë, si dhe qëllimeve të ngjashme.

Neni 10

Në nenin 58 fjalët "luftës nacionalçlirimtare" të zëvendësohen me fjalët "luftës antifashiste".

Neni 11

Pas nenit 71 shtohet neni 71a me këtë përmbajtje:

Marrja e ujit pa të drejtë

Administrimi i ujit pa të drejtë, duke kthyer ose ndryshuar vijën e ujit, duke hapur pendat, duke ndërtuar apo mbyllur kanale kullues apo vaditës, vija ose vepra të tjera, duke bërë punime pa leje në rrjetin e ujësjellësit për ujë të pijshëm, dënohet:

me gjobë ose me heqje të lirisë gjer në dy vjet.

Neni 12

Pas nenit 77 shtohet neni 77-a me këtë përmbajtje:

Fshehja e të ardhurave

Fshehja ose tregimi i rremë i të ardhurave ose i objekteve që i nënshtrohen tatimeve dhe taksave, dënohet:

me gjobë ose me heqje të lirisë gjer në një vit.

Neni 13

Pas nenit 77-a shtohet neni 77-b me këtë përmbajtje:

Mospagimi i tatimeve dhe taksave

Mospagimi i tatimeve dhe taksave brenda afatit të caktuar, me gjithë mundësinë e pagimit të tyre, nga një person ndaj të cilit janë marrë masa administrative për nxjerrjen e tatimeve ose taksave, dënohet:

me gjobë gjer në dyfishin e shumës së tatimit ose taksës të papaguar ose me heqje të lirisë gjer në dy vjet.

Neni 14

Neni 118 ndryshohet si vijon:

Fyerja dhe shpifja ndaj organeve kushtetuese

Personi që fyen ose shpif publikisht ndaj organit ligjvënës, qeverisë ose organeve të tjera kushtetuese ose një anëtar të tyre, dënohet:

me heqje të lirisë nga tre muaj gjer në dy vjet.

Neni 15

Pas nenit 119 shtohet neni 119-a me këtë përmbajtje:

Fyerja dhe shpifja kundër Presidentit të Republikës

Fyerja e Pres identit të Republikës botërisht, në mbledhje ose nëpërmjet shpërndarjes së shkrimeve, dënohet:

me heqje të lirisë nga gjashtë muaj gjer në tre vjet.

Shpifja kundër Presidentit të Republikës, që cenon nderin dhe dinjitetin e tij, dënohet:

me heqje të lirisë nga gjashtë muaj gjer në pesë vjet.

Ndjekja penale për këto vepra fillon vetëm me autorizimin e Presidentit të Republikës.

Neni 16

Pas nenit 119-a shtohet neni 119-b me këtë përmbajtje:

Fyerja e shtetit dhe e simboleve të tij

Personi që botërisht, në mbledhje apo nëpërmjet botimit ose shpërndarjes së shkrimeve, fyen Republikën e Shqipërisë, rendin e saj kushtetues, flamurin, stemën, himnin kombëtar e dëshmorët e kombit dënohet:

- me heqje të lirisë nga gjashtë muaj gjer në tre vjet.

Neni 17

Pas nenit 120-a shtohet neni 120-b me këtë përmbajtje:

Fyerja e organeve dhe e përfaqësuesve të shteteve të tjera

Personi që fyen një kryetar shteti ose anëtarin e një qeverie të huaj, që gjenden zyrtarisht në Republikën e Shqipërisë ose një drejtues të një përfaqësie diplomatike në Republikën e Shqipërisë, dënohet:

- me gjobë ose me heqje të lirisë gjer në tre vjet.

Neni 18

Paragrafi i dytë i nenit 134 ndryshohet si vijon:

Kultivimi i bimëve ose tregtimi i farërave për prodhimin e narkotikëve, përgatitja, importimi, mbajtja dhe shitja e drogës dhe e lëndëve narkotike pa leje, dënohet:

- me heqje të lirisë nga tre gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

Neni 19

Neni 176 ndryshohet si vijon:

Plagosja e lehtë nga pakujdesia dënohet:

-me gjobë nga dhjetëmijë gjer në njëzetmijë lekë.

Neni 20

Pas nenit 187 shtohet neni 187-a me këtë përmbajtje:

Cenimi i sekreteve personale

Nxjerrja e një sekreti, që i përket jetës private të një personi, nga ai që i është besuar ose i

është bërë e njohur për shkak të profesionit apo të detyrës, kur ai detyrohet të mos e nxjerrë atë pa qenë i autorizuar, dënohet:

-me gjobë ose me heqje të lirisë gjer në një vit

Nxjerrja e sekretit me qëllim fitimi ose për të dëmtuar një tjetër, dënohet:

-me gjobë ose me heqje të lirisë gjer në dy vjet.

Neni 21

Neni 196 ndryshohet si vijon:

Përvetësimi i pasurisë private të gjetur ose të rënë në dorë gabimisht ose rastësisht, dënohet:

-me gjobë nga dhjetë mijë gjer në njëqind mijë lekë ose me heqje të lirisë gjer në një vit.

Neni 22

Hiqet dënimi me vdekje për krimet e parashikuara nga nenet 51, 52, 58, 60-a, 62 dhe 101, paragrafi i dytë.

Neni 23

Shfuqizohen nenet 20 dhe 25 të Kodit Penal.

Neni 24

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.704, datë 30.11.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha